

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 SPORTIT DHE RINISË
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIM I MATURËS SHTETËRORE 2021
 ME ZGJEDHJE – SESIONI I

Qershor 2021

Ora 10.00

Lënda: Gjeografi

GI

VARIANTI A

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej 60 pikë.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është 2 orë e 30 minuta.

Testi ka 20 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim dhe arsyetim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

1. Për 20 pyetjet me zgjedhje (alternativa), pasi të keni qarkuar alternativën e saktë në test, duhet të mbushni rrathët përkatës të tabelës në fletë përgjigje:

Lexoni me kujdes udhëzimet e dhëna në fletë përgjigje.

2. Për pyetjet me zhvillim dhe arsyetim, përgjigjet duhet të shkruhen brenda zonës së kufizuar me vijë. Çdo përgjigje e shkruar jashtë vijave kufizuese, nuk do të vlerësohet.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	5	7	10	12	14	22	23
Pikët							
Kërkesa	24	25	26	31	32	33	34
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.Anëtar

1. Formimi i stinëve ndodh si pasojë e:

1 pikë

- A) rrotullimit të Tokës rreth vetes;
- B) rrotullimit të Hënës rreth vetes;
- C) qarkullimit të Tokës rreth Diellit;
- D) qarkullimit të Hënës rreth Tokës.

2. Në sa zona orare ndahet Toka?


1 pikë

- A) 12
- B) 16
- C) 20
- D) 24

3. Cila nga pikat e dhëna në figurë ka gjerësi gjeografike më të madhe?

1 pikë

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4



4. Vija që bashkonë vende me lartësi të njëjtë quhen:

1 pikë

- A) izohipse;
- B) izohieta;
- C) izobate;
- D) izobare.


5. Vëzhgoni me kujdes hartën e dhënë.

a) Cili lloj i projeksionit hartografik është përdorur?

1 pikë

b) Si paraqiten meridianët dhe paralelet në këtë lloj projeksioni?

1 pikë




6. Një nga pasojat e shpërthimeve të mëdha vullkanike është edhe ftohja e klimës. Kjo ndodh pasi aktiviteti vullkanik zakonisht:

1 pikë

- A) zvogëlon tejdukshmërinë e atmosferës;
- B) zvogëlon sasinë e grimcave të pluhurit në atmosferë;
- C) rrit sasinë e lagështirës në atmosferë;
- D) rrit reflektimin e rrezeve të Diellit në atmosferë.

7. Analizoni të dhënat e grafikut 1 dhe më pas përcaktoni llojin e klimës që paraqet ai.

3 pikë



8. Cila është tendenca e lëvizjeve të rrymave oqeanike?


1 pikë

- A) Rrymat oqeanike të ftohta lëvizin nga gjerësitë e vogla gjeografike drejt gjerësive më të mëdha gjeografike.
 B) Rrymat oqeanike të ngrohta lëvizin nga gjerësitë e vogla gjeografike drejt gjerësive më të mëdha gjeografike.
 C) Rrymat oqeanike të ftohta lëvizin vetëm në zonat e ftohta polare.
 D) Rrymat oqeanike të ngrohta lëvizin vetëm në zonat e ngrohta ekuatoriale.

9. Cilin nga elementet e valës tregon shkronja C në figurën e mëposhtme?

1 pikë

- A) Bazën.
 B) Gjatësinë.
 C) Kreshtën.
 D) Lartësinë.



10. Figura e mëposhtme tregon pozicionin e Hënës kundrejt Tokës. Pikat A, B, C dhe D tregojnë pika të ndryshme në sipërfaqen e Tokës.


a) Bazuar te figura, në cilat pika ndodhin baticat?

Hëna



1 pikë

b) Shpjegoni përgjigjen tuaj.



2 pikë

11. Korja e Tokës së bashku me pjesën e sipërme të mantelit përbën atë që quhet:

1 pikë

- A) shtresa e Mohoroviçit;
 B) manteli i Tokës;
 C) astenosferë;
 D) litosferë.

12. Shpjegoni si formohen secili prej shkëmbinjve të mëposhtëm.

2 pikë

Shkëmbinjtë magmatikë intruzivë:

Shkëmbinjtë magmatikë efuzivë:

13. Tjetërsimi fizik që ndodh për shkak të luhatjeve të temperaturës gjatë 24 orëve, shfaqet më shumë në:
1 pikë
- A) zonat detare;
B) zonat e tundrës;
C) zonat shkretinore;
D) zonat e pyjeve me lagështirë.
14. Era ndikon në ndryshimin e sipërfaqes së Tokës përmes veprimtarisë së saj shkatërruese, transportuese dhe depozituese.
- a) Si quhet veprimtaria shkatërruese e erës, nëpërmjet materialit që ajo mbart? 1 pikë
- _____
- b) Jepni dy kushte kur kjo veprimtari shkatërruese është më e madhe: 2 pikë
- _____
- _____
- _____
15. Cili nga pohimet e mëposhtme është përcaktues për imigracionin? 1 pikë
- A) Procesi i largimit të një grupi njerëzish nga një territor i caktuar.
B) Procesi i ardhjes së një grupi njerëzish në një territor të ri.
C) Procesi i largimit të një grupi njerëzish nga një shtet në një shtet tjetër.
D) Procesi i lëvizjes së një grupi njerëzish brenda kufijve të një rajoni.
16. Cili nga shtetet e mëposhtme dallohet për numrin e madh të gejzerëve: 1 pikë
- A) Suedia;
B) Islanda;
C) Norvegjia;
D) Danimarka.
17. Lumi më i gjatë në Evropë është: 1 pikë
- A) Danubi;
B) Reni;
C) Vollga;
D) Oder.
18. Popullsia indigjene në Australi përfaqësohet nga ajo: 1 pikë
- A) negroide;
B) maori;
C) metise;
D) aborigjene.

19. Cili nga faktorët e mëposhtëm është përcaktuesi më i rëndësishëm i klimës në Rajonin e Evropës Perëndimore?
1 pikë

- A) Ndikimi i veprimtarisë së njeriut.
- B) Ndikimi i rrymave oqeanike.
- C) Largësia nga deti.
- D) Format e relievit.

20. Italia shtrihet në gadishullin:
1 pikë


- A) Apenin;
- B) Iberik;
- C) Skandinav;
- D) Bretanjës.

21. Malet Apalashë me moshë të vjetër dhe të pasur me minerale gjenden në:
1 pikë

- A) perëndim të Amerikës së Veriut;
- B) lindje të Amerikës së Veriut;
- C) veri të Amerikës së Veriut;
- D) jug të Amerikës së Veriut.

22. Shkruani tri veçori fiziko–gjeografike (në aspektin e pozitës gjeografike dhe relievit) të rajonit të Evropës Mesdhetare.
3 pikë

23. Në figurë paraqiten tri piramida popullsie.



a) Përcaktoni se cila nga piramidat dallohet për:
3 pikë

- Rritje të ngadaltë të popullsisë: _____
- Rritje të shpejtë të popullsisë: _____
- Rritje negative të popullsisë: _____

b) Cila nga piramidat është karakteristike për vendet e pazhvilluara të Afrikës.
1 pikë

24. Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë një nga vendet më të zhvilluara ekonomisht të botës. Jepni tri nga arsyet që kanë ndikuar në zhvillimin e madh ekonomik të saj. **3 pikë**

- _____
- _____
- _____

25. Zhvillimi global i ekonomisë botërore është shoqëruar me pabarazi hapësinore midis qendrës (vendeve të zhvilluara) dhe periferisë (vendeve në zhvillim). Qendra dhe periferia kanë një lidhje të ndërsjelltë shkëmbimi midis tyre. Përcaktoni:

a) Çfarë i jep qendra periferisë në këtë shkëmbim? **1 pikë**

- _____

b) Çfarë i jep periferia qendrës në këtë shkëmbim? **1 pikë**

- _____

26. Për t'ju përgjigjur pyetjes, bazohuni në hartën e mëposhtme.

a) Cilin rajon tregon në hartë pjesa me ngjyrën më të errët? **1 pikë**

b) Identifikoni një nga lumenjtë më të rëndësishëm të këtij rajoni, që derdhet në gjirin Persik. **1 pikë**

c) Cili është kalimi strategjik i rajonit që lidh detin Mesdhe me Detin e Kuq? **1 pikë**



27. Cili nga rajonet e Shqipërisë dallohet për përqëndrimin më të madh të popullsisë? **1 pikë**

- A) Rajoni Verior – Verilindor.
- B) Rajoni Perëndimor.
- C) Rajoni Juglindor.
- D) Rajoni Jugor.

28. Shtrihet me drejtim veri-jug, në lindje të vargjeve të Lurës:

1 pikë

- A) lugina e Shkumbinit të Mesëm;
- B) lugina e Matit;
- C) lugina e Drinit të Zi;
- D) lugina e Kardhiqit.

29. Alpet Perëndimore të Shqipërisë ndahen nga Alpet Lindore nëpërmjet luginës së:

1 pikë


- A) Shalës;
- B) Valbonës;
- C) Cemit;
- D) Kirit.

30. Zona më e madhe kodrinore e Rajonit Perëndimor është ajo e:

1 pikë

- A) Kërrabës,
- B) Mallakastrës,
- C) Rodon-Kërrabë,
- D) Divjakë-Ardenicë.

31. Grafiku i mëposhtëm tregon ecurinë e numrit të popullsisë së Shqipërisë në vite të ndryshme.



a) Në cilën periudhë kohore numri i popullsisë është rritur nga 2 milionë banorë në mbi 3 milionë banorë?

1 pikë

b) Jepni një nga faktorët që kanë ndikuar në shtimin e numrit të popullsisë në këtë periudhë.

1 pikë

c) Cili është shkaku kryesor i rënies së numrit të popullsisë pas vitit 1989?

1 pikë

32. Migrimi i brendshëm është një dukuri që ndodh në të gjithë botën.

a) Cili nga rajonet gjeografike në Republikën e Shqipërisë ka përjetuar largim masiv të popullsisë? **1 pikë**

b) Jepni një nga pasojat e kësaj dukurie për zonat pritëse dhe për zonat nga ku largohet popullsia. **2 pikë**

Për zonat pritëse:

Për zonat nga ku largohet popullsia:

33. Jepni tri nga karakteristikat e vargut malor të Korabit. **3 pikë**

34. Pas vitit 1945 Shqipëria ndoqi rrugën e vet për zhvillimin ekonomik të vendit.

a) Cila degë e industrisë mori përparësi në vitet 1945-1990 në Shqipëri? **1 pikë**

b) A solli rritje të mirëqenies së popullsisë industrializimi i vendit? Jepni dy argumente për të mbështetur përgjigjen tuaj. **2 pikë**
